



INFORMATA BAZIKE:

Lajmëruesit e Dezinformatave – Monitorimi i Mediave Ruse është një raport mujor i lajmeve që përmbajnë dezinformata dhe keqinformime që e vëjnë në shënjestër Kosovën, dhe që janë të botuara në mediat ruse në gjuhën angleze dhe serbe.

PËRKRAHUR NGA:



Londër, Mbetëria e Bashkuar

VËREJTJE:

Pikëpamjet e paraqitura në këtë publikim janë vetëm të Institutit Kosovar për Hulumtim dhe Zhvillim të Politikave (KIPRED).

KONTAKTI:

Instituti Kosovar për Kërkime dhe Zhvillim të Politikave (KIPRED)
Rr. Major Mehmet Bushi, H.III/1
10 000 Prishtina, Kosovo
Tel: +383 (0)38 542 778
Web-site: www.kipred.org
Email: info@kipred.org

LAJMËRUESIT E DEZINFORMATAVE PËR KOSOVËN

MEDIAT RUSE

KORRIK 2020

HYRJE

Lajmëruesi i Dezinformatave për Kosovën: Mbikëqyrja e Mediave Ruse, synon t'i kundërvihet dezinformatave që e vejnë në shënjestër Kosovën, përmes mbikëqyrjes në bazë mujore të botimeve mediale të përzgjedhura, si në gjuhën angleze, ashtu edhe në atë serbe, që origjinën e kënë në Rusi. Mediat e përzgjedhura në gjuhën angleze janë Russia Today, Sputnik, Meduza, Russia Insider, TASS, The Moscow Times, Newsfront, Unz, The Duran, dhe Pravda Report, ndërsa në gjuhën serbe është Sputnik Serbia. Pos kësaj, Lajmëruesit e Dezinformatave për Kosovën i mbikëqyrin edhe lajmet, dokumentet dhe deklaratat që kanë të bëjnë me Kosovën, të botuara nga Kremli dhe nga Ministria Ruse e Punëve të Jashtme.

Gjatë korrikut 2020, TASS i ka botuar 5 lajme, Russia Today 6, The Duran 4, Sputnik International 3, Newsfront 6, Russia Insider 3, The Moscow Times 1, dhe Sputnik Serbia i ka botuar edhe 164 lajme të tjera që në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë kanë patur të bëjnë me Kosovën. Ndërkohë, Meduza, UNZ dhe Pravda Report nuk kanë botuar asnjë lajm të ndërlidhur me Kosovën. Nga ana tjetër, gjatë kësaj periudhe monitoruese, Kremli nuk e kishte asnjë, ndërsa Ministria e Jashtme Ruse i kishte 4 postime që kishin të bënin me Kosovën në ueb-sajtet e tyre.

Për shkak të numrit të madh të artikujve me përmbajtje dezinformuese të prodhuar nga këto media, në këtë botim janë analizuar vetëm artikujt me përmbajtjet dezinformuese më flagrante. Dezinformatat e bëra synojnë t'ia rrënojnë themelet legalitetit të shtetësisë së Kosovës, dhe t'i diskreditojnë institucionet dhe udhëheqësinë e Kosovës. Pos kësaj, këto dezinformata Kosovën e projektojnë si një shtet i dështuar që nuk i respekton të drejtat njerëzore të serbëve dhe të pakicave të tjera jo-shqiptare, dhe që ndërmerr veprime diskriminuese kundër komunitetit serb të Kosovës. Artikujt e përzgjedhur po ashtu synojnë ta mjugullojnë të kaluarën përmes *de facto* mohimit të krimeve dhe mizorive të Serbisë në Kosovë gjatë viteve 90, dhe përmes paraqitjes së serbëve si viktimë gjatë luftës së Kosovës, me synim të qartë të barazimit të viktimës (shqiptarët) me agresorin (serbët) gjatë konfliktit të Kosovës në vitin 1999.

DEKONSTRUKTIMI I DEZINFORMATAVE TË DETEKTUARA

Lajmërim i Dezinformatës 1

Titulli: *The Empire Bombed Serbia to Seize Kosovo in 1999* [Perandoria e bombardoi Serbinë më 1999 për ta pushtuar Kosovën], **The Duran**, 6 korrik 2020.¹

Artikulli pretendon që SHBA-të e kanë bombarduar Serbinë për dy arsye. Së pari, meqë “Perandoria Amerikane,” që pas shpërbërjes së Paktit të Varshavës ishte duke u zvogëluar, kishte nevojë për një luftë për ta parandaluar “uljen në shpenzimet ushtarake dhe mbylljen e shumicës së bazave ushtarake në Evropë.” Dhe, së dyti, meqë Serbia “haptas kundërshtoi ta hapte ekonominë e saj për bankat dhe korporatat amerikane dhe refuzoi t’i bashkangjitej Bashkimit Evropian.” Për më tepër, artikulli i referohet pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) si “imigrantë shqiptarë në krahinën e Serbisë të Kosovës,” dhe pretendon që CIA i ka dhënë “armatim UÇK-së islamike” dhe “i ka transportuar me qindra mercenarë të al-Qaedës në Kosovë për t’i sulmuar Serbët.” Artikulli përfundon duke pohuar që ushtarët serbë ishin dërguar në krahinën e Kosovës me qëllim që t’i frenojnë këta pushtues islamikë.

Dekonstruktimi i Dezinformatës: Fakte dhe Shifra

a) NATO e bombardoi Serbinë për ta parandaluar katastrofën humanitare dhe spastrimin etnik

Artikulli parashtron pretendime të rreme për arsyet e bombardimit të Serbisë nga NATO-ja gjatë konfliktit të Kosovës në 1999. Pas përfundimit të Luftës së Ftohtë dhe shpërbërjes së Bashkimit Sovjetik dhe të Paktit të Varshavës, SHBA-të nuk ishin duke u zvogëluar, por ishin e vetmja superfuqi e pasfiduar në botë. Meqë periudha e viteve 1990 referohet si kohë e hegjemonisë

¹*The Empire Bombed Serbia to Seize Kosovo in 1999* [Perandoria e bombardoi Serbinë më 1999 për ta pushtuar Kosovën], The Duran, 6 korrik 2020, <https://theduran.com/the-empire-bombed-serbia-to-seize-kosovo-in-1999/>

amerikane, SHBA-të me siguri se nuk kishin nevojë për ndonjë luftë për ta parandaluar “uljen e shpenzimeve ushtarake dhe mbylljen e shumicës së bazave ushtarake në Evropë.” Po ashtu, fushata ajrore e NATO-s me siguri se nuk u ndërmorr meqë Serbia “i kundërshtoi hapur kërkesat për ta hapur ekonominë e vet para bankave dhe korporatave perëndimore dhe refuzoi t’i bashkangjitej Bashkimit Evropian.” Në vend të kësaj, është fakt thelbësor që fushata e bombardimeve ishte rezultat i mizorive të Millosheviqit kundër shqiptarëve të Kosovës, dhe i refuzimit të tij për ta nënshkruar Marrëveshjen e Rambouillet-së të ndërmjetësuar nga Ambasadori amerikan Christopher Hill, i Dërguari i BE-së, Ambasadori Wolfgang Petritsch, dhe Ambasadori rus Boris Mayorski.² Këtu është e rëndësishme të theksohet ajo se para intervenimit të NATO-s, forcat jugosllave tashmë i kishin vrarë 2.000, burgosur mbi 1.200, dhe i kishin zhvendosur rreth 300.000 shqiptarë të Kosovës.³ Të gjitha këto fakte bëhen të qarta dhe të dukshme në deklaratën e 24 marsit 1999 të Presidentit të SHBA-ve Clinton, në të cilën ai theksonte që “Ne dhe aleatët tonë të NATO-s e kemi ndërmarrë këtë veprim pas përpjekjeve të gjera dhe të përsëritura për ta siguruar një zgjidhje paqësore për krizën në Kosovë,” dhe që goditjet ushtarake i kishin qëllimet në vijim: “ta demonstrojnë vendosmërinë e NATO-s, ta përmbajnë Beogradin nga nisja e ofensivave të reja kundër shqiptarëve të Kosovës, dhe t’i ulin aftësitë ushtarake të Jugosllavisë për të bërë sulme në të ardhmen.”⁴

b) UÇK-ja nuk ishte një formacion ushtarak islamik

Konflikti në Kosovë i vitit 1999 ishte konflikt midis shqiptarëve etnikë që jetonin aty dhe forcave ushtarake, policore dhe paramilitare serbe. Ushtria Çlirimtare e Kosovës (UÇK) ishte një formacion ushtarak gueril që ishte krijuar me qëllimin e çlirimit të Kosovës nga pushtimi i Serbisë dhe për mbrojtjen e popullatës civile nga mizoritë e ushtruar nga forcat ushtarake, policore dhe

² Marrëveshja e Rambouillet-së: Konkluzionet e Bashkë-Kryesuesit, 23 shkurt 1999, https://web.archive.org/web/20070926234216/http://www.ohr.int/other-doc/contact-g/default.asp?content_id=3560

³ Eric Herring, From Rambouillet to the Kosovo accords: NATO'S war against Serbia and its aftermath [Nga Rambouillet-ja në marrëveshjen për Kosovën: Lufta e NATO-s kundër Serbisë dhe pasojat], The International Journal of Human Rights, Routledge, Tetor 2007.

⁴ Shih: CNN: NATO Attack on Yugoslavia begins [CNN: Fillon Sulmi i NATO-s kundër Jugosllavisë], 24 mars 1999, <http://edition.cnn.com/WORLD/europe/9903/24/kosovo.strikes/>

paramilitare serbe. Pjesëtarët e UÇK-së nuk ishin as “imigrantë shqiptarë,” as “pushtues islamikë,” ashtu siç artikulli pretendon në mënyrë të rreme. Pjesëtarët e UÇK-së ishin shqiptarë etnikë të Kosovës, dhe gjatë gjithë periudhës së konfliktit të armatosur të viteve 1998–1999, UÇK-ja vazhdimisht e ka theksuar vetëm etninë shqiptare, dhe në këtë mënyrë është përpjekur ta parandalojë që identiteti shqiptar Perëndimit t’i paraqitet si mysliman. As UÇK-ja, dhe asnjë grup apo guerile tjetër politike e shqiptarëve të Kosovës, veten nuk e ka identifikuar me përkushtime fetare. Kështu, ideologjia e UÇK-së ka qenë pothuaj në tërësi ajo e nacionalizmit shqiptar, me theks në etninë shqiptare, dhe me aspirata dhe kulturë nacionaliste. Për më tepër, për shkak të homogjenizimit dhe mobilizimit të fuqishëm të shqiptarëve që nga viti 1989, UÇK-ja ka qenë në gjendje që veten ta izolonte lehtësisht nga idetë e huaja të fundamentalizmit islamik nga Arabia Saudite, që vinin nga numra të vegjël të njerëzve në Kosovë për t’u infiltruar në radhët e UÇK-së.⁵ Një realitet i tillë, mes tjerash, është dëshmuar edhe nga gazetarja e Newsweek-ut, Stacy Sullivan, e cila shkruante: “në dy vitet që e kam mbuluar konfliktin në Kosovë, asnjëherë nuk kam parë luftëtarë muxhahedinë të cilët i shihja në Bosnje, dhe as nuk kam dëgjuar ushtarë të UÇK-së që ta bëjnë madje edhe një aludim të vetëm të çfarëdo qoftë lloji për përkushtimin ndaj Islamit.”⁶ Prandaj, pretendimi i artikullit që CIA “i ka transportuar me qindra mercenarë të al-Qaedës në Kosovë për t’i sulmuar serbët, është po ashtu i rremë.”

Lajmërim i Dezinformatës 2

Titulli: *New Kosovo Indictment Is A Reminder Of Bill Clinton's Serbian War Atrocities* [Aktakuza e re në Kosovë është një përkujtim i mizorive të luftës së Bill Clintonit ndaj serbëve] **Russia Insider,** 23 July 2020.⁷

⁵ Henry H. Perrit, *Kosovo Liberation Army: The Inside Story of an Insurgency* [Ushtria Çlirimtare e Kosovës: Rrëfimi i Brendshëm i një Kryengritjeje], University of Illinois Press, 2008.

⁶ Michael J. Totten, “Kosovo’s Moderate Muslims: The world’s newest country is a model of tolerance” [Myslimanët e Moderuar të Kosovës: Vendi më i ri në botë është model i tolerancës], *The Wall Street Journal*, 30 dhjetor 2008, <http://www.wsj.com/articles/SB123059201269240805>

⁷ **James Bovard**, *New Kosovo Indictment Is A Reminder Of Bill Clinton's Serbian War Atrocities* [Aktakuza e re e Kosovës është një përkujtim i mizorive të Bill Clintonit të luftës kundër Serbisë], *Russia Insider*, 23 korrik 2020, <https://russia-insider.com/en/new-kosovo-indictment-reminder-bill-clintons-serbian-war-atrocities/ri30959>

Siç tregohet edhe në titull, artikulli pohon që akuza ndaj Presidentit Thaçi është një “përkujtim i mizorive të luftës ndaj Serbisë të Bill Clintonit.” Ky e akuzon Presidentin Clinton për përhapjen e “doktrinës” së tij sipas së cilës presidentët e SHBA-ve “e kanë të drejtën të fillojnë t’i bombardojnë vendet e huaja bazuar në çfarëdo gënjeshtre të pacipë që do ta zbrazin mediat amerikane.” Sipas artikullit, fushata bombarduese 78-ditëshe e nisur nga administrata e Clintonit, të cilën mediat amerikane e paraqitën si një kryqëzatë kundër paragjyqimeve etnike, në të vërtetë vrau deri në njëmijë e pesëqind civilë në Serbi dhe në Kosovë. Prandaj, sipas artikullit, “ajo luftë, si edhe shumica e pretendimeve të politikës së jashtme të Shteteve të Bashkuara, gjatë gjithë kohës ishte një mashtrim.” Artikulli më tutje pohon që Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, është akuzuar nga tribunali ndërkombëtar në Hagë se është “penalisht përgjegjës për afër 100 vrasje,” duke thënë njëkohësisht që akuza përfshinte “qindra viktime të njohura që ishin shqiptarë e serbë të Kosovës, romë, dhe pjesëtarë të etnive të tjera.” Ky po ashtu pohon që “UÇK-ja ishte e përfshirë thellë në trafikimin e drogave dhe kishte lidhje të afërta me Osama bin Ladenin.” Sipas artikullit, gazeta *The Guardian* ka shkruar që rrethi i brendshëm i Thaçit gjoja “pas luftës i kishte çuar të zënë rob përtej kufirit, në Shqipëri, ku një numër i serbëve ishin vrarë për veshkat e tyre, të cilat ishin shitur në tregun e zi.” Për më tepër, ky pohon se kur “kirurgët transplantues” ishin të gatshëm të operonin, robërit [serbë] ishin nxjerrë jashtë nga ‘shtëpia e sigurtë,’ individualisht ishin ekzekutuar aty për aty nga banditët e UÇK-së, dhe trupat e tyre ishin transportuar me të shpejtë në klinikën operuese.” Artikulli po ashtu i akuzon forcat amerikane dhe ato të NATO-s për atë që thjeshtë kanë bërë sehir ndërkohë që “UÇK-ja e vazhdonte spastrimin e vet etnik, duke therrur civilë serbë, duke bombarduar kisha serbe dhe duke shtypur çdo jo-mysliman. Pothuaj një çerek milioni serbë, romë, çifutë dhe pakica të tjera janë arratisur nga Kosova.” Sipas artikullit, deri në vitin 2003, gati 70 përqind të serbëve që në Kosovë kishin jetuar në vitin 1999 ishin arratisur, dhe Kosova tash është bërë 95 përqind shqiptare.

Dekonstruktimi i Dezinformatës: Fakte dhe Shifra

Artikulli e bën një mori pohimesh të rreme kundër Presidentit Clinton, Shteteve të Bashkuara dhe forcave të NATO-s, si dhe kundër Presidentit Thaçi dhe UÇK-së. Ky po ashtu e përmban një numër të pohimeve të papërputhshme dhe kontradiktore. Kur e përmend aktakuzën kundër Presidentit Thaçi, artikulli pohon që ai është akuzuar për krimet e luftës nga **tribunali ndërkombëtar në Hagë**, edhe pse është e qartë që Thaçi është akuzuar nga Zyra e Prokurorit të Specializuar (SPO) të Odave të Specializuara të Kosovës (KSC), që janë themeluar me vendimin e Kuvendit të Kosovës të 3 korrikut 2015.⁸ Kur e citon akuzën, artikulli fillimisht pohon që Presidenti Thaçi është akuzuar se është “përgjegjës për afërsisht 100 vrasje,” ndërkohë që më vonë pohon që akuza përfshin “qindra viktima të njohura.” Artikulli po ashtu pretendon se me nisjen e fushatës së bombardimeve kundër Serbisë në vitin 1999, Presidenti Clinton ka kryer mizori të luftës në Serbi. Për më tepër, artikulli pretendon në mënyrë të rreme që fushata e bombardimeve e cila nga mediat amerikane është paraqitur si një kryqëzatë kundër paragjyqimeve etnike, në të vërtetë ka qenë një mashtrim. E qartë, autori i artikullit e shpërfill faktin që para intervenimit të NATO-s forcat jugosllave tashmë kishin vrarë 2,000, burgosur mbi 1,200, dhe zhvendosur rreth 300,000 shqiptarë kosovarë.⁹ Duke i vënë në pyetje këto vuajtje njerëzore dhe duke e emërtuar intervenimin e NATO-s si mashtrim, autori qartë i shpërfill jetët e viktimave shqiptare dhe dimensionin humanitar të intervenimit të NATO-s, dhe e akuzon Clintonin për mizori të luftës. Më poshtë janë dhënë disa fakte dhe shifra shtesë që e dekonstruktojnë dezinformimin në këtë artikull.

a) Ekzagjerimi i numrit të paraqitur të viktimave

Artikulli pretendon në mënyrë të rreme se fushata 78-ditëshe e bombardimeve i ka vrarë deri në një mijë e pesëqind civilë në Serbi dhe në Kosovë. Të dhënat e hollësishme të grumbulluara bazuar në 31,600 dokumente, të dhëna në botimin “Libri i Kujtesës i Kosovës” (2 shkurt 2015), i cili është

⁸ Ligji për Odat Speciale dhe Zyren e Prokurorit të Specializuar, Gazeta Zyrtare e Kosovës, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=11036>

⁹ Eric Herring, From Rambouillet to the Kosovo accords: NATO'S war against Serbia and its aftermath [Nga marrëveshja e Rambouillet-së e deri te ajo e Kosovës: Lufta e NATO-s kundër Serbisë dhe pasojat e saj], The International Journal of Human Rights, Routledge, tetor 2007.

përgatitur nga Qendra për të Drejtën Humanitare në Beograd, konfirmojnë se një total prej 754 njerëzish janë vrarë në sulmet e NATO-s: 454 prej tyre kanë qenë civilë, dhe 300 ishin pjesëtarë të forcave të armatosura. Në mesin e civilëve, numri më i madh, 219, ishin civilët shqiptarë, 207 ishin civilë të etnive serbe dhe malazeze, 14 ishin romë, dhe 14 ishin të kombësive të tjera. E qartë, të dhënat e dokumentuara tregojnë që numri i vdekjeve gjatë Fushatës Ajrore të NATO-s ishte shumë më i ulët se 1,500, ashtu siç e paraqet artikulli.

b) Manipulimi i numrit të refugjatëve serbë të Kosovës pas luftës

Artikulli po ashtu pretendon në mënyrë të rreme që pas vendosjes së trupave të NATO-s, UÇK-ja e ka kryer një spastrim etnik që bëri që pothuaj një çerek milionë serbë, romë, çifutë, e minoritete të tjera, të arratisen nga Kosova. Pos kësaj, ky pohon që deri në vitin 2003 janë arratisur gati 70 përqind të serbëve që në Kosovë kishin jetuar në vitin 1999. Sipas Raportit të botuar nga Qendra Koordinuese për Kosovën e Qeverisë së Serbisë, në shkurtin e vitit 2002 në Kosovë kanë jetuar 129,474 serbë. Nga ana tjetër, sipas regjistrimit të fundit jugosllav të vitit 1991, në Kosovë atëherë kanë jetuar 194,000 serbë, me gjasa tepër të vogla të ndonjë trendi që ky numër të rritet gjatë viteve 90.¹⁰ Këto shifra e projektojnë një numër prej më së shumti 75,000 serbësh që Kosovën e kanë braktisur pas luftës, dhe i cili me siguri se nuk është as për së afërmi afër 70 përqindëshit, dhe është shumë më i vogël se 250,000 veta sa pretendon artikulli.

c) Nuk ka kurrfarë dëshmish për trafikimin me organe njerëzore

Artikulli pohon në mënyrë të rreme se rrethi i ngushtë i UÇK-së i Thaçit ishte i përfshirë në trafikimin e organeve njerëzore gjatë periudhës së luftës 1998–1999. Akuzat e tilla u përmendën për herë të parë në Raportin e Dick Martyt që u botua më 14 dhjetor 2010 dhe u prezantua para Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës me 7 janar 2011. Raporti pretendonte për “trajtim çnjerëzor të njerëzve dhe vrasje të të zënëve rob me qëllim të heqjes dhe trafikimit të

¹⁰ Për hulumtim të më tutjeshëm, shih: The Lausanne Principle: Security, Territory and the Future of the Kosovo Serbs [Parimi i Lausanne-s: Siguria, Territori dhe e Ardhmja e Serbëve të Kosovës], European Stability Initiative, 7 qershor, 2004, https://www.esiweb.org/pdf/esi_document_id_53.pdf

paligjshëm të organeve njerëzore në Kosovë nga pjesëtarët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.” Mirëpo, deklarata nga Clint Williamson, Kryeprokuror i Task Forcës Speciale Hetuese të Bashkimit Evropian, e 29 korrikut 2014 pohon se ndjekja e shkeljeve lidhur me trafikimin e organeve njerëzore “e kërkon një nivel të dëshmime që deri më tash nuk e kemi siguruar.”¹¹ Nga ana tjetër, aktakuza në të cilën artikulli është duke u thirrur, nuk përmend fare padi lidhur me trafikimin e organeve njerëzore. Deklarata nga Zyra e Prokurorit të Specializuar (SPO) e Odave të Specializuara të Kosovës (KSC) e 24 qershorit 2020 pohon qartë që krimet e pretenduara në aktakuzë e përfshijnë “një brez krimesh kundër njerëzimit dhe të krimeve të luftës, përfshirë vrasje, zhdukje të detyruara të njerëzve, përndjekje dhe torturime,”¹² por nuk përmend akund trafikim të organeve njerëzore.

Lajmërim i Dezinformatës 3

Titulli: *Удружење: Отворити архиве „УЧК“, Кфора, ОЕБС-а (Shoqata: Të hapen arkivat e “UÇK-së, të KFOR-it, të OSCE-së), Sputnik Serbia, 27 korrik 2020.*¹³

Artikulli pohon që familjet e serbëve të rrëmbyer dhe të vvarë në Kosovë kanë kërkuar hapjen e arkivave të UÇK-së, të KFOR-it, si dhe të OSCE-së dhe të Komitetit Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq (ICRC), ashtu që të gjenden vend-ndodhjet e serbëve të rrëmbyer në vitin 1998, si dhe varrezat masive të të gjitha viktimave të Kosmetit [Kosovës] gjatë viteve 1998, 1999 dhe 2000. Ky po ashtu e transmeton deklaratën e Asociacionit të Familjeve të të Rrëmbyerve dhe të Vvarëve në Kosovë, e cila pretendon që Tribunali i Hagës të tërë përgjegjësinë e ka vënë në komandën e tyre, dhe ka dënuar vetëm gjeneralët serbë, ndërkohë që udhëheqësit e UÇK-së ishin të mbrojtur nga drejtësia. Për më tepër, sipas deklaratës, dëshmitë me emrat e rrëmbyesve dhe të kriminelëve u

¹¹ Clint Williamson, “Statement of the Chief Prosecutor of the Special Investigative Task Force” [“Deklaratw e Kryeprokurorit tw Task Forcws Hetuese Speciale”], Brussels, European Union, 29 korrik 2014.

¹² “Press Statement” Specialist Prosecutor’s Office, Kosovo Specialist Chambers [Deklaratë për Shtyp, Zyra e Prokurorit të Specializuar, Odat e Specializuara të Kosovës], 24 qershor 2020.

¹³ “Удружење: Отворити архиве „УЧК“, Кфора, ОЕБС-а (Shoqata: Të hapen arkivat e “UÇK-së”, KFOR-it, OSCE-së),” Sputnik Serbia, 27 korrik 2020, <https://rs.sputniknews.com/vesti/202007271123089188-udruzenje-otvoriti-arhive-uck-kfora-oebs-kosovo/>

ishin dhënë prokurorëve të Hagës, mirëpo ata ato dëshmi i mbajtën si tejet sekrete, me qëllim që t'i mbrojnë kriminelët e luftës të tillë si Thaçi, Haradinaj, Limaj dhe Veseli. Pos kësaj, deklarata pretendon se me veprime të tilla, prokurorët i kanë shkëmbyer jetët e serbëve të rrëmbyer, ashtu që në zemër të Evropës ta krijojnë “shtetin islamik të UÇK-së, ISIS Kosova.”

Dekonstruktimi i Dezinformatës: Fakte dhe Shifra

Artikulli e bën pohimin për varrezat e serbëve të vrarë dhe të rrëmbyer në Kosovë, në një përpjekje që luftën çlirimtare të UÇK-së ta paraqesë në një mënyrë të rreme si një luftë të krimeve të luftës dhe kundër njerëzimit. Kjo është pjesë e një fushate agresive dhe të koordinuar që përpiqet që serbët t'i paraqesë si viktima gjatë luftës së Kosovës, ndërkohë që krimet e luftës të kryera nga forcat ushtarake, policore dhe paramilitare serbe minimizohen dhe fshihen. Në realitet, të dhënat e raportuara nga institucione të besueshme, të tilla si Komisioni Ndërkombëtar për Personat e Zhdukur (ICMP) dhe Human Rights Watch, tregojnë qartë që shumica dërrmuese e personave të vrarë, të rrëmbyer dhe të zhdukur gjatë konfliktit kanë qenë shqiptarë, dhe jo serbë etnikë. Për më tepër, raportet e këtyre institucioneve tregojnë jashta çdo dyshimi që pjesa më e madhe e këtyre krimeve janë kryer nga forcat ushtarake, policore dhe paramilitare serbe, dhe jo nga UÇK-ja. Dhe, së fundi, të gjitha varrezat e identifikuara masive kanë qenë ato të shqiptarëve etnikë, dhe nuk ka qenë as edhe një e vetme e serbëve etnikë.

Më konkretisht, vlerësohet që më shumë se 7,000 persona kanë qenë të zhdukur gjatë konfliktit në Kosovë të vitit 1999. Deri në korrikun 2001, Tribunali Ndërkombëtar Kriminal për ish-Jugosllavinë (ICTY) i ka zhvarrosur përafërsisht rreth 4,300 trupa. Sipas Komitetit Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq, deri në prillin e vitit 2001, kanë mbetur 3,525 njerëz të zhdukur në konflikt – shumica dërrmuese e tyre shqiptarë të Kosovës.¹⁴ Nga ana tjetër, sipas Komisionit Ndërkombëtar për Personat e Zhdukur (ICMP), midis viteve 2001 dhe 2002, nga varrezat klandestine në territorin e Serbisë janë nxjerrë trupat e rreth 840 personave. Të gjitha mbetjet mortore të nxjerra në Serbi

¹⁴ “Under Orders: War Crimes in Kosovo” [“Nën Urdhëra: Krimet e Luftës në Kosovë”], Human Rights Watch Report, 2001, fq. 7, https://www.hrw.org/sites/default/files/report_pdf/kosovo_full_low.pdf.

gjatë periudhës 2001–2002 kanë qenë të shqiptarëve të Kosovës, të ekzekutuar në vitin 1999.¹⁵ Sipas ICTY dhe Human Rights Watch, vështirësia kryesore në gjetjen e personave të zhdukur ka qenë përpjekja e qëllimshme e qeverisë serbe dhe jugosllave për t'i shkatërruar dëshmitë dhe për t'i zhvendosur trupat. Ka raste të dokumentuara ku trupat janë zhvarrosur dhe janë larguar nga skenat e krimit, në përpjekje të qarta për t'i fshehur vrasjet. Për më tepër, një radio-dokumentar në National Public Radio në Shtetet e Bashkuara, i quajtur “Burning the Evidence” [“Djegia e Dëshmive”], ka pohuar që forcat serbe dhe jugosllave në mënyrë sistematike i kanë transportuar trupat e shqiptarëve kosovarë në kompleksin xehtar në Trepçë, afër Mitrovicës, ku ata janë djegur.¹⁶

Artikulli po ashtu pohon në mënyrë të rreme që në zemër të Evropës është krijuar “shteti islamik i UÇK-së, ISIS Kosova.” Ashtu siç tashmë u shpjegua, gjatë tërë konfliktit të viteve 1998–1999, UÇK-ja në vazhdimësi e ka theksuar vetëm etninë shqiptare, dhe është përpjekur ta parandalojë që identiteti shqiptar Perëndimit t’i paraqitet si identitet mysliman. As UÇK-ja, dhe as ndonjë grup apo guerilë tjetër shqiptare, veten nuk e ka identifikuar sipas përkatësisë fetare. Kështu, ideologjia e UÇK-së ka qenë pothuaj në tërësi një e nacionalizmit shqiptar, me theks në etninë shqiptare, dhe në aspiratat e kulturën kombëtare. Për më tepër, për shkak të homogjenizimit dhe mobilizimit të fuqishëm etnik të shqiptarëve që nga viti 1989, UÇK-ja veten e ka izoluar lehtësisht nga idetë e huaja të fundamentalizmit islamik nga Arabia Saudite, që kanë ardhur në Kosovë përmes një numri të vogël të njerëzve për t’u infiltruar në radhët e UÇK-së.¹⁷ Një realitet i tillë, mes tjerash, është dëshmuar edhe nga gazetarja e Newsweekut, Stacy Sullivan, e cila kishte shkruar: “Në dy vite sa e kam mbuluar konfliktin në Kosovë, asnjë herë nuk kam parë luftëtarë

¹⁵ Shih “The Situation in Kosovo: A Stock Taking” [“Situata në Kosovë: Marrja e gjendjes”], The International Commission on Missing Persons (ICMP), Sarajevë, 14 shtator 2010.

¹⁶ Sipas luftëtarëve serbë, dhe “një oficeri serb të inteligjencës në pozitë të lartë,” midis 1.200 dhe 1,500 trupa janë asgjësuar në Trepçë. Shih: “Under Orders: War Crimes in Kosovo” [“Nën Urdhëra: Krimet e Luftës në Kosovë”], 2001, fq. 122.

¹⁷ Henry H. Perrit, *Kosovo Liberation Army: The Inside Story of an Insurgency [Ushtria Çlirimtare e Kosovës: Rrëfimi i Brendshëm i një Kryengritjeje]*, University of Illinois Press, 2008.

muxhahedinë si në Bosnje, dhe as nuk e kam dëgjuar ndonjë ushtar të UÇK-së që madje edhe të aludojë në çfarëdo qoftë përkushtimi ndaj Islamit.”¹⁸

Lajmërim i Dezinformatës 4

Titulli: *Priština izbegava da preda ključni dokument za nastavak dijaloga sa Beogradom (Prishtina i shmanget dorëzimit të dokumentit kyç për vazhdimin e dialogut me Beogradin), Sputnik Serbia, 20 korrik 2020.*¹⁹

Artikulli pohon që gjatë takimit të ekipeve të ekspertëve të Prishtinës dhe Beogradit në Bruksel, është e mundshme që ata do të diskutojnë për gjetjen e mënyrave për shkëmbimin e të dhënave për personat e zhdukur. Më pastaj ky e citon analistin politik Dragomir Andjelković, që i shpreh dyshimet e veta për zgjidhjen e shpejtë të çështjes së personave të zhdukur, meqë ai beson se Prishtina nuk do t’ia dorëzojë Beogradit arkivat e kërkuara të UÇK-së, meqë kjo “do ta prishë propagandën e krijuar të Perëndimit – që vetëm sistemi serb i sigurisë ka kryer krime në Kosovë.” Andjelković më pas pretendon se nëse autoritetet e Kosovës do të “pranojnë tash që t’i japin lokacionet dhe të dhënat e kërkuara, ata do të pranojnë që kjo nuk ka qenë ndonjë reagim spontan ndaj krimeve serbe, por një përpjekje sistematike shqiptare për ta bërë spastrimin etnik të Kosovës.” Për më tepër, sipas Andjelkovićit, numri i serbëve të zhdukur në Kosovë është 1,644, një numër kyç që është i afërt me atë që përmendet nga pala shqiptare.

¹⁸ Michael J. Totten, “Kosovo's Moderate Muslims: The world's newest country is a model of tolerance” [“Myslimanët e Moderuar të Kosovës: Vendi më i ri i botës është model i tolerancës”], The Wall Street Journal, 30 dhjetor 2008, <http://www.wsj.com/articles/SB123059201269240805>

¹⁹ “Priština izbegava da preda ključni dokument za nastavak dijaloga sa Beogradom [“Prishtina i shmanget dorëzimit të dokumentit kyç për vazhdimin e dialogut me Beogradin:], *Sputnik Serbia*, 20 korrik 2020, <https://rs-lat.sputniknews.com/politika/202007201123040073-pristina-izbegava-da-preda-kljucni-dokument-za-nastavak-dijaloga-sa-beogradom--/>

Dekonstruktimi i Dezinformatës: Fakte dhe Shifra

Ky është edhe një artikull që përpiqet që serbët t'i paraqesë rrejtshëm si viktimë gjatë luftës së Kosovës, dhe që t'i minimizojë e fshehë krimet e luftës të kryera gjatë konfliktit nga forcat ushtarake, policore dhe paraushtarake serbe, me synim të barazimit të viktimës me agresorin. Artikulli e citon analistin politik Andjelković, i cili pretendon se fakti që “vetëm sistemi i sigurisë serbe ka kryer krime në Kosovë,” është vetëm një propagandë e krijuar nga Perëndimi. Andjelković, më tutje, e shpërfill faktin që krimet e kryera nga forcat ushtarake, policore dhe paramilitare serbe kundër shqiptarëve të Kosovës janë dokumentuar nga institucione të besueshme dhe të njohura. Raporti i Human Rights Watch gjatë konfliktit në Kosovë në vitin 1999 ka dokumentuar “torturime, vrasje, dhunime, dëbime të dhunshme, dhe krime të tjera të luftës, të kryera nga forcat qeveritare serbe dhe jugosllave kundër shqiptarëve të Kosovës midis 24 marsit dhe 12 qershorit, 1999.” Ky raport e ka zbuluar po ashtu “një fushatë të koordinuar dhe sistematike për t'i terrorizuar, vrarë, dhe dëbuar shqiptarët etnikë të Kosovës, që është organizuar nga nivelet më të larta të qeverive serbe dhe jugosllave që ishin në pushtet në atë kohë.”²⁰ Më konkretisht, bazuar në burime të ndryshme, Raporti ka përfunduar që “përafërsisht 10,500 shqiptarë të Kosovës janë vrarë midis 20 marsit dhe 12 qershorit 1999, me një interval të konfidencës prej 95 përqind, prej 7,449 deri në 13,627.”

Nga ana tjetër, Andjelković pohon në mënyrë të rreme që numri i serbëve të zhdukur është 1,644, një numër ky që, sipas tij, është i afërt me atë që përmendet nga pala shqiptare. Deri në qershorin 2001, Tribunali Ndërkombëtar Kriminal për ish-Jugosllavinë (ICTY) i ka nxjerrë afërsisht 4,300 trupa. Sipas Komitetit Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq, deri në prillin e vitit 2001, 3,525 njerëz mbeten të zhdukur nga konflikti – shumica dërrmuese e tyre shqiptarë të Kosovës.²¹ Pos kësaj, sipas Komisionit Ndërkombëtar për Personat e Zhdukur (ICPM), midis viteve 2001 dhe 2002, trupat e 840 personave janë nxjerrë nga varrezat e fshehta në territorin e Serbisë. Të gjitha mbetjet mortore të gjetura në Serbi gjatë viteve 2001–2002 ishin të shqiptarëve të Kosovës, të

²⁰ Për hollësi lidhur me krimet e luftës në Kosovë gjatë luftës së vitit 1999, shih “Under Orders: War Crimes in Kosovo” [“Nën Urdhëra: Krimet e Luftës në Kosovë”], Human Rights Watch Report, 2001,

https://www.hrw.org/sites/default/files/report_pdf/kosovo_full_low.pdf

²¹ “Under Orders: War Crimes in Kosovo,” Human Rights Watch Report, 2001, fq. 7,

https://www.hrw.org/sites/default/files/report_pdf/kosovo_full_low.pdf.

ekzekutuar në vitin 1999.²² Edhe ICTY-ja, edhe Human Rights Watch, e bëjnë të ditur që pengesa kryesore në gjetjen e personave të zhdukur qëndron në përpjekjet e paramenduara të qeverive serbe dhe jugosllave për t'i shkatërruar dëshmitë dhe për t'i hequr trupat. Ka raste të dokumentuara ku trupat janë zhvarrosur dhe zhvendosur nga skenat e krimit, në një përpjekje të qartë për t'i fshehur vrasjet. Më e rëndësishmja, ka dëshmi të pakundërshtueshme të ngatërrimeve të varreve dhe zhvendosjes së trupave nga trupat serbe dhe jugosllave, ndërkohë që qeveria serbe pas Millosheviqit ishte duke filluar ta forconte veten në verën e vitit 2001.²³

Lajmërim i Dezinformatës 5

Titulli: *Вратите нам слободу! Једина жеља Срба на Косову пред преговоре у Бриселу (Na ktheni lirinë! E vetmja dëshirë e serbëve në Kosovë para negociatave në Bruksel), Sputnik Serbia, 7 korrik 2020.*²⁴

Artikulli pohon që dialogu midis Prishtinës dhe Beogradit në Bruksel ka fare pak domethënie për serbin e rëndomtë në Kosovë, nëse nuk ka paqe në shtëpitë e tij, nëse ai nuk është në gjendje ta punojë tokën e vet, dhe nëse duhet t'i dërgojë fëmijët e vet në Serbinë qendrore dhe në Beograd për t'i arsimuar dhe punuar. Sipas Živojin Rakočevićit, gazetar dhe publicist nga Kosova, të gjitha problemet në Kosovë vijnë nga mungesa e lirisë në të cilën serbët jetojnë. Ai më pas e parashtron një numër pyetjesh: “kur ata [serbët] do të jenë qytetarë të barabartë në një shoqëri të ndërtuar nga një botë demokratike, kur ata do të çlirohen nga frika, kur do të ndalen së menduari se ku po shkojnë nga ndjenja e pasigurisë, kur do ta kenë të drejtën për të marrë vendime dhe për të

²² See “The Situation in Kosovo: A Stock Taking” [“Situata në Kosovë: Marrja e gjendjes”], The International Commission on Missing Persons (ICMP) [Komisioni Ndërkombëtar për Personat e Zhdukur], Sarajevë, 14 shtator 2010.

²³ Sipas luftëtarëve serbë, dhe “një oficeri serb të inteligjencës në pozitë të lartë,” midis 1.200 dhe 1,500 trupa janë asgjësuar në Trepçë. Shih: “Under Orders: War Crimes in Kosovo” [“Nën Urdhëra: Krimet e Luftës në Kosovë”], 2001, fq. 122.

²⁴ Бранкица Ристић, “Вратите нам слободу! Једина жеља Срба на Косову пред преговоре у Бриселу (Na ktheni lirinë! E vetmja dëshirë e serbëve në Kosovë para negociatave në Bruksel), Sputnik Serbia, 7 korrik 2020, <https://rs.sputniknews.com/analize/202007071122949305-vratite-nam-slobodu-jedina-zelja-srba-na-kosovu-pred-pregovore-u-briselu/>

vendosur për vetveten, kur do ta ushtrojnë të drejtën për ta përdorur gjuhën dhe shkrimin e tyre, ...”. Rakočevići po ashtu pohon se projekti i Kosovës nuk mund të ekzistojë pa të drejtat themelore të njeriut, dhe pretendon se “serbët janë vetëm duke i kërkuar të drejtat themelore njerëzore, por askush nuk është duke i pyetur ata për lirinë, dhe ky është thelbi i fshehur i projektit të dështuar të quajtur Kosovë.” Artikulli po ashtu ua përkujton lexuesve që në Kosovë, sulmet kundër serbëve, dhe posaçërisht kundër serbëve të kthyer, kohëve të fundit janë bërë më të shpeshta. Ky pohon që shtëpive të tyre u vihet zjarri, bagëtia dhe pronat u vidhen, njësoj si edhe traktorët, veturat, paratë

Dekonstruktimi i Dezinformatës: Fakte dhe Shifra

a) Kosova është një shoqëri multi-etnike me një respektim të lartë të të drejtave njerëzore të të gjithë qytetarëve jo-shqiptarë

Artikulli pohon se të gjitha të drejtat njerëzore të serbëve që jetojnë në Kosovë nuk janë duke u respektuar, dhe përpiqet që Kosovën ta paraqesë si një shtet që i shtyp komunitetet e veta etnike pakicë. Artikulli pretendon në mënyrë të rreme se serbët nuk janë qytetarë të barabartë në shoqëri, meqë Neni 3 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës e pohon qartë që Kosova “është një shoqëri multi-etnike që përbëhet nga komuniteti shqiptar dhe nga komunitetet e tjera, që udhëhiqet demokratikisht me një respektim të plotë të sundimit të ligjit përmes institucioneve të veta legjislative, ekzekutive dhe gjyqësore.”²⁵ Për më tepër, Neni 22 pohon që krahas me instrumentet e tjera ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, “Konventa Kornizë e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare” është drejtpërdrejtë e zbatueshme në Kosovë.”²⁶

Nga këndvështrimi i pretendimit se serbët nuk kanë të drejtë ta përdorin gjuhën e tyre, Neni 5 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës,²⁷ shqipen dhe serbishten i përcakton si dy gjuhët zyrtare,

²⁵ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Kuvendi i Republikës së Kosovës, Neni 3, 15 qershor 2008, <http://kryeministri-ks.net/wpcontent/uploads/2018/03/Kushtetuta.e.Republikes.se..Kosoves-2.pdf>

²⁶ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Neni 22.

²⁷ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Neni 5.

me një status të barabartë para institucioneve. Ligji për Përdorimin e Gjuhëve po ashtu i referohet Kushtetutës, dhe thotë që verzionet e shqipes dhe të serbishtes janë “njësoj autoritative,” që don të thotë se asnjëra nga to nuk ka përparësi mbi tjetrën kur fjala vjen të përkthimi.²⁸ Artikulli po ashtu e parashton pyetjen: “kur ata do ta kenë të drejtën për të marrë vendime dhe të drejtën për të vendosur për vetveten,” duke pretenduar përsëri në mënyrë të rreme që serbëve në Kosovë u mungon përfaqësimi politik. Në nivelin qendror, Neni 64 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës pohon qartë se në Kuvendin e Kosovës “njëzet (20) nga njëqind e njëzet (120) ulëset u garantohen për përfaqësim komuniteteve që nuk janë në shumicë në Kosovë.”²⁹

Nga ana tjetër, Neni 96 pohon qartë se “do të jetë të paktën një (1) Ministër nga Komuniteti i Serbëve të Kosovës dhe një (1) Ministër nga ndonjë komunitet tjetër jo-shumicë i Kosovës. Nëse ka më shumë se dymbëdhjetë (12) Ministra, Qeveria do ta ketë Ministrin e tretë që e përfaqëson një Komunitet jo-shumicë në Kosovë.”³⁰

Në nivelin lokal, si pjesë e procesit të decentralizimit, në Kosovë aktualisht janë 10 komuna me shumicë serbe. Pos nivelit të lartë të vetëqeverisjes lokale të cilin e gëzojnë të gjitha komunat, ato me shumicë serbe kanë pushtete shtesë në caktimin e komandantëve të policisë lokale, vendeve të trashëgimisë fetare dhe kulturore brenda kufijve të tyre, disa nga to kanë kompetenca mbi universitete dhe kujdesin shëndetësor dytësor, e të cilat në komunat që nuk kanë shumicë serbe janë çështje e qeverisjes qendrore.³¹ Të gjitha këto dispozita në Kushtetutë dhe në vetëqeverisjen lokale e tregojnë qartë nivelin e lartë të respektimit të të drejtave njerëzore të të gjithë qytetarëve jo-shqiptarë të Kosovës.

²⁸ Ligji Nr. 02/L-37 për Përdorimin e Gjuhëve, Nenet 2 dhe 5, ashtu siç janë shpallur nga Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2006/51, 20 tetor 2006.

²⁹ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Neni 64.

³⁰ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Neni 96.

³¹ “Organizimi dhe Funksionimi i Vetëqeverisjes Lokale në Kosovë,” Qeveria e Republikës së Kosovës, Prishtinë, Gusht 2013.

b) Në Kosovë nuk ka pasur incidente me motivime etnike gjatë gjashtë muajve të parë të vitit 2020

Ngjashëm me mediat e tjera në Serbi, edhe ky artikull pretendon që numri i incidenteve kundër serbëve lokalë në Kosovë është rritur kohëve të fundit. Artikulli pohon që “shtëpive të serbëve u vihët zjarri, bagëtia dhe pronat u vidhen, njësoj si edhe traktorët, veturat, paratë ...”. Mirëpo, në shumicën e rasteve, pa kurrfarë konfirmimesh zyrtare nga institucionet përkatëse, apo pavarësisht nga deklaratat zyrtare të këtyre institucioneve, mediat serbe çdo herë si kryerës të veprave i paraqesin shqiptarët. Meqë rëndom nuk është e mundur që për incidentet e hamendësuara të gjenden lajme të tjera pos atyre serbe, KIPRED-i në disa raste është dashur të kontaktojë me Policinë e Kosovës dhe të kërkojë deklarata nga ajo. Sipas Zyres për Informim të Policisë së Kosovës, PK është një institucion për zbatimin e ligjit dhe në të gjitha rastet vepron në pajtim me detyrat dhe autorizimet e veta ligjore, ashtu që ta ruaj rendin dhe qetësinë publike, dhe kjo ushtron trajtim korrekt të të gjithë personave, pa kurrfarë dallimesh. Pos kësaj, Policia e Kosovës e ka ofruar informatën zyrtare për dhunën me motivime etnike në Kosovë gjatë periudhës 01.01.2020 – 30.06.2020. Sipas Raportit të saj, gjatë kësaj periudhe nuk ka pasur raste të inicuar me motivime ndëretnike kur fjala është për “shkeljet penale kundër jetës dhe trupit.”

Lajmërim i Dezinformatës 6

Titulli: *Свет чека шок због страшног злочина над Србима: „Жетва“ би могла да пољуља творевину „Косово“ (Botën e pret një tronditje pas krimit të tmerrshëm kundër serbëve: “Korrja” mund ta trondisë krijesën e Kosovës), Sputnik Serbia, 27 korrik 2020.*³²

Artikulli e diskuton filmin “Korrja” të regjisorit amerikan Paul Kampf, i cili, sipas artikullit, do t’i bëjë shumë vende që ta tërheqin njohjen e tyre të Kosovës, dhe që “kjo krijesë e çuditshme e quajtur “Kosovë,” thjeshtë, do të shpërthejë si një fluskë sapuni,” një herë pasi që bota ta shohë

³² “Свет чека шок због страшног злочина над Србима: „Жетва“ би могла да пољуља творевину „Косово“ (Botën e pret një tronditje pas krimit të tmerrshëm kundër serbëve: “Korrja” mund ta trondisë krijimin e Kosovës),” Sputnik Serbia, 27 korri 2020, <https://rs.sputniknews.com/analize/202007271123091672-svet-ceka-sok-zbog-strasnog-zlocina-nad-srbima-zetva-bi-mogla-da-poljulja-tvorevinu-kosovo/>

vërtetë se mbi çfarë është e mbështetur. Filmi është i mbështetur në romanin “Zemra serbe e Johannit” të Veselin Dzeletovićit, i cili gjoja e tregon një rrëfim të vërtetë për gjermanin e pasur Johan, të cilit i është transplantuar zemra e viktimës serbe të “shtëpisë së verdhë,” i cili vie në Kosovë për t’i gjurmuar përgjigjet në pyetjet e veta thelbësore. Sipas Dzeletovićit, romani është një rrëfim për vuajtjet serbe në Kosovë, një rrëfim që mund t’i ndryshojë imazhet e këqija që janë krijuar për serbët anembanë botës. Ai thotë se për të pjesa më e rëndësishme e rrëfimit është që romani ka ndikuar që disa vende ta tërheqin njohjen e Kosovës. Filmi “Korrja,” nga ana tjetër, është një film për krimet kundër serbëve në Kosovë. Artikulli pohon se edhe pse serbët janë paraqitur çdokund si tipa të këqinj, e vërteta është në tërësi e ndryshme. Më tutje, ai pohon se ndërkohë që Perëndimi është përpjekur që pjesëtarët organizatës terroriste të Kosovës t’i paraqesë në një dritë tjetër, ata në realitet mund të përshkruhen me vetëm një fjalë – kriminelë. Dzeletovići pohon që mëkati i kryer nga shqiptarët është shumë i madh, dhe që bota do ta shohë se sa shumë zemra serbe janë duke rrahur anembanë botës. Sipas tij, ka “indikacione se deri në 2,500 serbë kanë përfunduar si viktima të trafikimit të organeve, gjë që është përbindëshe.” Sipas kritikut dhe teoricienit të filmave, Božidar Zečević, romani dhe filmi janë frymëzuar dhe mbështetur në raportin e Dick Martyt, i cili është “mjaf i qartë për çdokë që don ta lexojë dhe ta dëgjojë të vërtetën.”

Dekonstruktimi i Dezinformatës: Fakte dhe Shifra

Ky është edhe një artikull tjetër që përpiket që serbët t’i paraqesë si viktima gjatë luftës së Kosovës, duke i ekzagjeruar viktimat serbe, dhe duke i minimizuar dhe fshehur krimet e luftës të kryera nga forcat ushtarake, policore dhe paramilitare serbe. Qëllimi i artikullit është në një mënyrë të qartë që t’i barazojë viktimën (shqiptarët) me agresorin (serbët) gjatë konfliktit në Kosovë në vitin 1999. Argumenti kryesor i artikullit është pretendimi i rremë për trafikimin e organeve njerëzore të serbëve gjatë luftës në Kosovë. Artikulli e diskuton filmin “Harvest” [“Korrja”] që bazohet në romanin “Zemra serbe e Johannit,” i cili gjoja e tregon një rrëfim të vërtetë për një gjerman të pasur me emrin Johann të cilit i është transplantuar zemra e viktimës serbe të “shtëpisë së verdhë.” Edhe filmi, edhe romani, kanë qenë të frymëzuar nga raporti i Dick Martyt i cili ka qenë i pari që ka bërë akuza për trafikimin e organeve njerëzore. Raporti që është

botuar më 14 dhjetor 2010 dhe që i është paraqitur Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës më 7 janar 2011, pretendonte “trajtime çnjerëzore të njerëzve dhe vrasje të të burgosurve me qëllim të heqjes dhe të trafikimit të paligjshëm me organe njerëzore në Kosovë nga anëtarët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Megjithatë, deklarata nga Clint Williamson, Kryeprokuror i Task Forcës Speciale Hetuese të Bashkimit Evropian, e 29 korrikut 2014 pohon se ndjekja penale e shkeljeve lidhur me trafikimin e organeve njerëzore “kërkon një nivel të dëshmimeve që ende nuk e kemi siguruar.”³³ Nga ana tjetër, aktakuza në të cilën artikulli është duke u referuar nuk e përmend fare ndonjë akuzë lidhur me trafikimin e organeve njerëzore. Deklarata e Zyres së Prokurorit të Specializuar (SPO) të Odave të Specializuara të Kosovës (KSC) e 24 qershorit 2020, pohon qartë që “krimet e supozuara në aktakuzë përfshijnë një brez të krimeve kundër njerëzimit dhe të krimeve të luftës, përfshirë vrasje, zhdukje të dhunshme të personave, persekutime, dhe torturime,”³⁴ por nuk përmend askund trafikim të organeve njerëzore.

la vlen të përmendet që artikulli pohon që krimet e kryera kundër serbëve në Kosovë janë monstruoze, meqë ka “indikacione se janë deri në **2,500** serbë që kanë përfunduar si viktime të trafikimit të organeve.” Në thelb, një numër i tillë të tërë artikullin e bën tejet të dyshimtë sipas të dhënave të hollësishme të grumbulluara bazuar në 31,600 dokumente, të paraqitura në botimin “Libri i Kujtesës i Kosovës” (2 shkurt 2015), i cili i përgatit nga Qendra për të Drejtën Humanitare me seli në Beograd, sipas të cilave një total prej 13,535 individësh janë vrarë apo zhdukur gjatë, dhe në kontekstin, e konfliktit të armatosur në Kosovë. Nga ta, numri i tërë i serbëve të vrarë gjatë konfliktit ka qenë **2,197**, më pas, 10,812 veta kanë qenë shqiptarë, dhe 526 viktime kanë qenë romë, boshnjakë, malazezë, dhe jo-shqiptarë të tjerë.

Për më tepër, artikulli pretendon se anembanë botës, janë krijuar padrejtësisht imazhe të këqija për serbët, meqë e vërteta është në tërësi tjetërfare. Sipas artikullit, Perëndimi është përpjekur t’i paraqesë pjesëtarët e organizatës terroriste të Kosovës në një dritë të ndryshme, por në realitet ata mund të përshkruhen vetëm me një fjalë të vetme – kriminelë. Autori i artikullit nuk i referohet Human Rights Watch, i cili tregon qartë që shumica dërrmuese e personave të vrarë,

³³ Clint Williamson, “Statement of the Chief Prosecutor of the Special Investigative Task Force” [Deklaratë e Kryeprokurorit të Task Forcës Speciale Hetuese], Brussels, European Union, 29 korrik 2014.

³⁴ “Press Statement” [Deklaratë për Shtyp], Specialist Prosecutor’s Office, Kosovo Specialist Chambers [Zyra e Prokurorit të Specializuar, Odat e Specializuara të Kosovës], 24 qershor 2020.

të rrëmbyer apo të zhdukur gjatë konfliktit kanë qenë shqiptarë, dhe jo serbë etnikë. Për më tepër, raporti tregon pa kurrfarë dyshimi se pjesa më e madhe e atyre krimeve janë kryer nga forcat ushtarake, policore dhe paramilitare serbe, dhe jo nga UÇK-ja. Më konkretisht, raporti i Human Rights Watch gjatë konfliktit të Kosovës në 1999 ka dokumentuar “torturime, vrasje, dhunime, dëbime të detyruara, dhe krime të tjera të luftës të kryera nga forcat qeveritare serbe dhe jugosllave kundër shqiptarëve të Kosovës midis 24 marsit dhe 12 qershorit 1999.” Raporti po ashtu e ka zbuluar “një fushatë të koordinuar dhe sistematike për të terrorizuar, vrarë dhe dëbuar shqiptarët etnikë të Kosovës, e cila ishte e organizuar nga nivelet më të larta të pushtetit të atëhershëm qeveritar serb dhe jugosllav.”³⁵

³⁵ Për hollësi lidhur me krimet e luftës në Kosovë, gjatë luftës së vitit 1999, shih: “Under Orders: War Crimes in Kosovo” [Nën Urdhëra: Krimet e Luftës në Kosovë], Human Rights Watch Report, 2001, https://www.hrw.org/sites/default/files/report_pdf/kosovo_full_low.pdf